



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel-Fax:042 232491

Nr. 852/7 Prot

Tiranë, më 30.12.2016

V E N D I M

Nr. 173, Datë 30.12.2016

PËR

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË
DEGËN DOGANORE SARANDË "MBI PËRPUTHSHMËRINË E
VEPRIMTARISË SË DEGËS DOGANORE SARANDË ME KRITERET
DHE KËRKESAT E KUADRIT RREGULLATOR NË FUQI"**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standarteve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi, në mbështetje të neneve 15, 25, 26 dhe 30 të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së degës doganore Sarandë me kriteret dhe kërkesat e kuadrit ligjor rregullator në fuqi", për periudhën 01.01.2015-31.12.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1-Nga auditimi i procedurave të zhdoganimit dhe klasifikimit tarifor të mallrave rezultoi se, autoriteti doganor kompetent Dega e Doganës Sarandës, gjatë procedura

ve të deklarimit doganor, ka pranuar për zhdoganim nga operatorët ekonomik, dokumentacion shoqërues fotokopje të pa noterizuar si: parking-list, certifikatë origjine malli, dhe në raste të veçantë edhe dokument Euro1, veprime në kundërshtim me kërkesat e parashikuara nga ligji nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe VKM nr. 205, datë 13.05.1999 “Për Dispozitat Zbatuese, të KD”.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 16 deri 73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:**

Autoriteti doganor kompetent Dega e Doganës Sarandë, të marr masa të plota organizative me qëllim që dokumentacioni shoqërues i pranuar në vlerësimin doganor të mallrave të administrohet me dokumente origjinale dhe jo fotokopje.

Menjëherë.

2-Nga auditimi i procedurave të zhdoganimit dhe klasifikimit tarifor të mallrave rezultoi se, për shumë operatorë ekonomikë në përlllogaritjen e vlerës doganore është pranuar çmimi i faturës së mallit, ndërsa për mallra me të njëjtën natyrë është kryer rivlerësim malli sipas të dhënave të disponueshme në RSH, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e parashikuara nga ligji nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe VKM nr. 205, datë 13.05.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të KD”, Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 “Për verifikimin e vlerës doganore”.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 16 deri 73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:**

Autoriteti doganor kompetent Dega e Doganës Sarandë të marrë masa që vlerësimi doganor të jetë në përputhje të plotë me shpjegimet Udhëzimit nr. 25, datë 13.11.2007 “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore,” dhe të mbështetet me procesverbale vlerësimi të indikatorëve në përmbushje të pikës 6 të Udhëzimit nr. 25, datë 13.11.2007 ku përcaktohet se “Llogaritja e vlerës së artikullit të dokumentohet nga një procesverbal sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi, ku duhet të plotësohen indikatorët e kontrolluar”

Menjëherë.

3. Për mallrat të cilat nuk kanë të dhëna të disponueshme si dhe për mallrat e përdorura nuk është nxjerrë urdhër nga dega doganore për miratimin dhe funksionimin e komisionit të vlerësimit, ku për vendimet e marra nga ky komision duhej të ishte njoftuar menjëherë DPD, në zbatim të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe të pikës 54-81 të VKM nr. 205, datë 13.03.1999 “Për dispozitat zbatuese të KD” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 “Për vlerën doganore”, udhëzimit nr. 6, 6/1/2 të DPD “Mbi vlerësimin doganor”,

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 16 deri 73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:**

Autoriteti doganor kompetent Dega e Doganës Sarandë të nxjerrë menjëherë urdhër të brendshëm për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të vlerësimit doganor, për të vlerësuar mallrat për të cilët nuk kanë të dhëna të disponueshme, si dhe për mallrat e përdorura.

Menjëherë.

4-Nga auditimi i ushtruar mbi veprimtarinë e sektorit të regjimeve të përpunimit aktiv (RPA) rezultoi se, për disa operatorë ekonomik konstatohen diferenca ndërmjet vlerës së mallit në import dhe vlerës së mallit në eksport, nuk është evidentuar vlera e mallit nga vlera e punës së kryer dhe mallra të importuar jashtë kodeve tarifore të aprovuara në autorizimet e regjimeve të përpunimit aktiv, veprime në kundërshtim me ligji nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; VKM nr. 205, datë 13.05.1999, neni 247 deri 325 dhe Udhëzimit nr. 1, datë 06.09.2012 “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 74 deri 79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Autoriteti Doganor Kompetent DD Sarandë, të kryejë verifikime doganore të përbashkëta mbi veprimtarinë e sektorit të regjimeve të përpunimit aktiv me pjesëmarrjen e specialistit të kontrollit pas zhdoganimit dhe personelit përpunues që ka mbikëqyrë regjimin e përpunimit aktiv, dhe për diferencat e lindura nga krahasimi ndërmjet vlerës së mallit në eksport dhe vlerës së mallit në import të deklaruar në formularin (Model 3), të llogarisë detyrimet e munguara doganore.

Menjëherë.

5. Gjendja e borxhit doganor është në nivele të larta me tendencë në rritje, arkëtimi dhe vjelja e borxhit të debitorëve është në nivele të ulëta dhe nuk ka bashkëpunim të mjaftueshëm midis Degës së Doganës Sarandë, me strukturat e DPD dhe institucionet e tjera me detyrim dhe kontribut në arkëtimin e borxhit siç janë; Zyra e Përmbarimit Gjyqësor, Sistemit Bankar, ZVRPP, DRSHTRR etj.

Për sa trajtuar më hollësisht në faqe nr. 82 deri 84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Autoriteti Doganor Kompetent, Dega e Doganës Sarandë të analizojë gjendjen e debitorëve, të përdorë të gjitha rrugët dhe mjetet ligjore me program pune të posaçëm dhe afate konkrete e të marrë të gjitha masat për rikuperimin me forcë të borxhit doganor të mbetur pa rikuperuar.

Në vazhdimësi

6. Nga auditimi ka rezultuar se, gjatë konstatimit të shkeljeve doganore në fushën e akcizës, në rastet kur janë evidentuar diferenca në mungesë të mallrave në magazinat fiskale të depozituesve të miratuar, që operojnë sipas ligjit nr. 61/2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nuk janë llogaritur dhe evidentuar detyrimet mbi TVSh-në, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 92 datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, sanksionet respektive sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9920 “Për

Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, për mallin e akcizës të gjetur në mungesë në Magazinat Fiskale të Depozituesve të Miratuar
Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 92 deri 97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Dega Doganore Sarandë në bashkëpunim me Departamentin e Akcizës, gjatë hartimit të akteve të konstatimit, nxjerrjes së vendimeve doganore për kontabilizimin e detyrimeve të akcizës, të njoftojnë në mënyrë të detyrueshme Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, mbi vlerën dhe sasinë e mallit të akcizës të gjetur në mungesë dhe të evidentojnë dhe detyrimet mbi TVSh^{-në}, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 92 datë 24.07.2014 “Për Tatim mbi Vlerën e Shtuar”, sanksionet respektive sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9920 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, për mallin e akcizës të gjetur në mungesë në Magazinat Fiskale të Depozituesve të Miratuar.

Menjëherë.

7-Nga auditimi dokumentacionit bashkëlidhur autorizimeve të përjashtimit u konstatuan se në asnjë rast të vetëm autoriteti doganor nuk ka kryer verifikime pranë selive të personave përfitues të autorizimit të përjashtimit nga detyrimi doganore sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar nenit 184 “Rastet e përjashtimeve dhe kushtet”, pika 3 “Përjashtime nga detyrimi i importit”, dhe pikës 96-104 të VKM nr 205 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” dhe ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor” i ndryshuar.
Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 80 deri 82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Dega Doganore Sarandë të kryejë verifikime të detyrueshme pranë selive të personave fizikë rezidentë shqiptarë me qëllim verifikimin e destinacionit të mallrave të deklaruara si “*sende personale*” dhe për të cilat është kërkuar përjashtimi nga detyrimet doganore të importit brenda afateve të përcaktuara në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar.

Menjëherë.

8-Nga auditimi u konstatua se për disa praktika doganore për të cilat janë marrë mostrat për përcaktimin e saktë të klasifikimit tarifor të mallit nuk janë kthyer përgjigjet laboratorike nga Drejtoria e Laboratorit Kimik Doganor, si dhe raste për moskryerjen e procedurës doganore të verifikimit doganor bazuar në përcaktimet ligjore të Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007, nisur nga dyshime të arsyeshme për pasojat të mundshme të shmangies së detyrimeve doganore nëpërmjet deklarimit të këtyre mallrave në nivele tarifore dhe vlera doganore më të ulëta të konstatuara këto gjatë procedurave të zhdoganimit të subjekteve “■” dhe “■”
Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 22 dhe 27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

8.1. Dega Doganore Sarandë në mos administrim të përgjigjes nga Laboratori Kimik Doganor për subjektin “■” me Nipt ■, të kryejë verifikime të dokumentacionit

shoqërues të praktikave doganore pranë Autoriteteve Doganore Homologe eksportuese me qëllim përcaktimin e saktë të klasifikimit tarifor të mallit si dhe të garantojë pjesën e borxhit që mund të lindë nga rezultatet e verifikimit doganor, bazuar sipas përcaktimeve ligjore të Pjesës VII kreu I “Garancia për të mbuluar një borxh doganor.

8. 2 Autoriteti Doganor Kompetent, Dega Doganore Sarandë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për subjektin “[REDACTED]” me Nipt [REDACTED] të kryejë verifikime të dokumentacionit shoqërues të praktikave doganore pranë Autoriteteve Doganore Homologe eksportuese, me qëllim përcaktimin e saktë të vlerës së transaktuar të mallit si dhe të garantojë pjesën e borxhit që mund të lindë nga rezultatet e verifikimit doganor, sipas përcaktimeve ligjore të Pjesës VII kreu I “Garancia për të mbuluar një borxh doganor”.

Menjëherë.

9-Nga auditimi u konstatua se nga personeli përpunues dokumentar nuk është pranuar vlera e transaksionit të paraqitur nga subjektet gjatë procedurave të zhdoganimit për artikullin “fidanë mandarina dhe portokall” por është ndërtuar një çmim në vlerën 1,8 euro/rrënja pa procesverbal të mbajtur nga komisioni i vlerësimit dhe për këtë rast nuk është informuar Departamentit Teknik në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave sipas shpjegimeve të Udhëzimit nr. 25 datë 30.11.2007 “Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore”. Po për të njëjtin artikull “fidanë mandarina dhe portokall”, për subjekte të tjera që operojnë në këtë degë Doganore nuk rezulton të jetë aplikuar çmimi 1,8 euro/rrënja sipas nivelit të vlerësimit në praktikën doganore R. 554, datë 28.04.2016 për artikujt “mallra identikë ose të ngjashëm”

Për sa trajtuar më hollësisht në faqe nr. 34 deri 35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:**

9.1. Ngritjen e komisionit të vlerësimit doganor për vlerësimin e artikullit “fidanë mandarina dhe portokall” për të sanksionuar vlerën doganore të aplikuar me çmimin 1,8 euro/rrënja në praktiken doganore IMP4 R. 554, datë 28.04.2016 pranë Degës Doganore Sarandë sipas përkufizimit të “mallrave identikë ose të ngjashëm” dhe vlerave identikë të pranura sipas shpjegimeve të Udhëzimit nr. 25 datë 30.11.2007 “Për Shqyrtimin e Vlerës Doganore” si dhe të informohet Departamenti Teknik pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për vendimmarrjen e komisionit të vlerësimit.

9.2. Në zbatim të nenit 102, “Shqyrtimi i deklaratës pas çlirimit të mallrave”, nenit 35 dhe 36 pika 1, “Metoda e zgjedhjes më të mirë dhe kufizimet” të Kodit Doganor të rillogariten dhe detyrime doganore të munguara për praktika doganore duke marrë si bazë vlerësimi doganor shënimet e vlerësimit doganor të cilësuar në praktikën doganore nr. R 554 datë 28.04.2016.

B. MASA ADMINISTRATIVE

Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me vlerësimin doganor rezultoi se nga agjencitë doganore, të cilat operojnë pranë Degës së Doganës Sarandë në cilësinë e përfaqësuesve të tërthortë të mallit, janë trajtuar me MSABE dhe janë keqklasifikuar artikuj me pasoje shmangien e detyrimeve doganore.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 23-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

1. Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Sarandë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, mbështetur në faktet e vërtetuara dhe në të dhënat e grumbulluara gjatë auditimit në terren, të marri masa bazuar në nenet 275.1 dhe 287.2/f të Kodit Doganor, si dhe nenit 41.2 të Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor, për penalitet në masën 50,000 deri në 200,000 lekë, për agjencitë doganore: [REDAKTUAR]” me nr. J 102 dhe “[REDAKTUAR]” me nr F 22.

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Dega e Doganës Sarandë, të kryejë kontabilizimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerë prej **24,697,991 lekë** sa më poshtë;

1-Vlerën prej **2,809,666 lekë** nga 33 (*tridhjetë e tre*) operator ekonomik, pasqyruar në Aneksi nr. 1 bashkëlidhur, sipas trajtimit në faqet (16-73) të Raportit të Auditimit, për rivlerësim të detyrimit doganor i pranuar me vlerën e transaksionit të faturës dhe shpenzime transporti, jo në përputhje me kërkesat dhe kriteret ligjore të parashikuara në neni 33- 38 të KD, për periudhën viti 2014; 2015; 6/mujori 2016.

Afati: deri në datë 30.03.2017

2-Vlerën prej **17,939,716 lekë** nga 18 (*tetëmbëdhjetë*) operator ekonomik, pasqyruar në Aneksi nr. 1 bashkëlidhur, sipas trajtimit në faqet (16-73) të Raportit të auditimit, për llogaritjen dhe vlerësimin e detyrimit doganor me keqklasifikim të artikujve jo në përputhje me Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave të parashikuara nga neni 256.1/2/3 dhe 275 të KD, për periudhën viti 2014; 2015; 6/mujori 2016.

Afati: deri në datë 30.03.2017

3-Vlerën prej **450,000 lekë** nga 3 (*tre*) operator ekonomik dhe 1(*një*) Agjenci doganore të pasqyruar në Aneksi nr. 1 bashkëlidhur, sipas trajtimit në faqet (16-73) të Raportit të auditimit, për penalitete kundravajtjet administrative të evidentuara në procesin e vlerësimit të detyrimit doganor, parashikuar nga neni 256.1/2/3 dhe 275 të KD, për periudhën viti 2014- 2015- 6/mujori 2016..

Afati: deri në datë 30.06.2016

4-Vlerën prej **1,206,399 lekë** nga 14 (*katërmëdhjetë*) operatorët ekonomik dhe 1 (*një*) Agjenci doganore të pasqyruar në Aneksi nr. 3 bashkëlidhur, sipas trajtimit në faqet (74-79) të Raportit të auditimit për llogaritjen dhe vlerësimin e detyrimit doganor për penalitete me kundërvajtjet administrative të evidentuara në procesin e mbikëqyrjes së regjimit përpunimit aktiv dhe përfitim të përjashtimit nga detyrimi doganor sipas autorizimit përkatës parashikuar nga neni 265.1/2 dhe 275 të KD, për periudhën viti 2014; 2015; 6/mujori 2016.

Afati: deri në datë 30.03.2017

5-Vlerën prej **1,000,000 lekë** nga 4 (*katër*) operator ekonomik, pasqyruar në Aneksi nr. 2 bashkëlidhur, sipas trajtimit në faqet (92-97) të Raportit të auditimit për penalitete me parregullsi në fushën e akcizës sipas autorizimeve përkatëse parashikuar nga neni 20.3/c të ligjit nr. 61, datë 24.05.2012 “Për Akcizën në RSH”, për periudhën viti 2014; 2015; 6/mujori 2016.

Afati: deri në datë 30.03.2017

6-Vlerën prej **1,292,210 lekë** nga 10 (*dhjetë*) operator ekonomik, pasqyruar në aneksi nr. 4, pasqyruar në faqet (85-92) të Raportit të auditimit duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe ato ligjore, për mos vjeljen e detyrimeve doganore dhe gjobave doganore gjatë vendimmarrjes administrative jo në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave dhe Kryetarit të Degës Doganore Sarandë, që në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme sipas pikës 1, gërma “a”; “b”; “c” të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013 të konsideruara nga ana jonë si shkelje shumë të rënda, të rënda dhe të lehta, të bëjnë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojnë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013:

a. Neni 58 gërma “c” “largim nga shërbimi civil” për nëpunësin civil, si më poshtë;
1-J. R., me detyrë doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik.

Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore, konkretisht:

-Për problemet e konstatuara në procedurat e vlerësimit doganor u konstatua se “*Certifikata Lëvizëse EUR.1*” dhe dokumentacioni shoqërues tregtar nuk përmbushin përcaktimet dhe shpjegimet e ligjit nr. 9733, datë 14/05/2007 “Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me Turqinë” si dhe dokumentacioni i përdorur si dokument për përfitimin e origjinës preferenciale MTLTR gjatë procedurave doganore të zhdoganimit nuk përmbush kushtet ligjore për përfitimin e trajtimit tarifor preferencial MTLTR.

b. Neni 58 gërma “b-c”, nga “mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” deri në “largim nga shërbimi civil” për nëpunësit civil, si më poshtë:

2-Gj. M., me detyrë doganier përgjegjës turni.

3-S. Zh., me detyrë doganier përgjegjës turni.

4-I. K., me detyrë doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik.

5-A. A., me detyrë doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik.

6-A. C., me detyrë doganier peshore.

7-A. B., me detyrë doganier kontroll fizik.

Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore, konkretisht:

-Për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore të cilat janë trajtuar me transaksion, jo në përputhje me kërkesat e neneve 33-37 të Kodit Doganor dhe kërkesave të Sesionit I, të Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave *“Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore”*, nxjerrë për këtë qëllim;

-Për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore me keqklasifikim artikujsh me pasojë shmangie të detyrimeve doganore, jo në përputhje me kërkesat e neneve 256.1/a; 256.2; 256.4; 261.1.2 të KD;

-Për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore trajtuar me origjinë preferenciale me nivel të taksës doganore 0% me deklaratë faturë, jo në përputhje me kërkesat e Titullit V, neni 22, Udhërrëfyesi *“Mbi rregullat e Origjinës Preferenciale”*, kushtet për lëshimin e një deklarate faturë citon: *“...Një deklaratë faturë mund të përgatitet nga një eksportues i aprovuar në kuptim të nenit 22, ose nga një eksportues i një dërgese të përbërë nga një ose më shumë paketime që përmbajnë produkte origjinuese, vlera e të cilave nuk i kalon 6000€...”*.

c. Neni 58 gërma “a-b-c”, nga “vërejtje”, “mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” deri në “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” për nëpunësit civil, si më poshtë:

8-E. S., me detyrë doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik.

9-K. D., me detyrë doganier kontroll fizik.

10-E. B., me detyrë doganier përgjegjës turni.

11-E. N., me detyrë doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik.

12-H. C., me detyrë doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik.

Për veprime në mospërputhje me ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të pikës 15.13 të VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, si dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 25 datë 30.11.2007 “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhëna të disponueshme” dhe në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore, konkretisht:

-Për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore të cilat janë trajtuar me transaksion jo në përputhje me kërkesat e neneve 33-37 të Kodit Doganor dhe kërkesave të Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave *“Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore”*, nxjerrë për këtë qëllim.

-Për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore me keqklasifikim artikujsh me pasojë shmangie të detyrimeve doganore, jo në përputhje me kërkesat e neneve 256.1/a; 256.2; 256.4; 261.1.2 të KD.

-Për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore trajtuar me origjinë preferenciale me nivel të taksës doganore 0% me deklaratë faturë, jo në përputhje me kërkesat e Titullit V, neni 22 të Udhërrëfyesit *“Mbi rregullat e Origjinës Preferenciale”*, kushtet për lëshimin e një deklarate faturë citon: *“...Një deklaratë faturë mund të përgatitet nga një eksportues i aprovuar në kuptim të nenit 22 ose nga*

një eksportues i një dërgese të përbërë nga një ose më shumë paketime që përmbajnë produkte origjinuese, vlera e të cilave nuk i kalon 6000 €... ”.

Shënim:

Për përgjegjësitë mbi të metat dhe mangësitë e konstatuara, të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nuk rekomandohet masë disiplinore për punonjësit:

z. S. H., znj. A. K., z. H. M., z. R. Gj., z. V. H., z. Sh. T., z. U. K., z. B. P., z. A. C., z. Sh. K., z. B. L., z. K. N., z. E. D..

Me ndjekjen dhe zbatimin e masave të rekomanduara me këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R